

**VENDIM**  
**Nr. 286, datë 10.5.2019**

**PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË KRYETARIT,  
NËNKRYETARIT DHE ANËTARËVE TË KOMITETIT PËR PAKICAT  
KOMBËTARE**

*(Ndryshuar me VKM nr. 548, datë 1.10.2025)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 20, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e procedurave të përzgjedhjes së kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarëve të Komitetit për Pakicat Kombëtare (në vijim “KPK”), nëpërmjet një procesi të pavarur, transparent e gjithëpërfshirës.

2. Përzgjedhja e kandidaturave për kryetarin, nënkryetarin dhe anëtarët e KPK-së kryhet nëpërmjet zbatimit të procedurave të hapura e publike të konkurrit, nga Kryeministria, bazuar në pikën 4, të nenit 20, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

3. *Procedurat e përzgjedhjes për kryetarin, nënkryetarin dhe anëtarët e KPK-së kryhen nga komisioni ad-hoc, i cili kryesohet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe ka në përbërje një përfaqësues nga këto institucione:*

- a) Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;*
- b) Akademia e Shkencave e Shqipërisë;*
- c) Ministria e Punëve të Brendshme;*
- d) Ministria e Arsimit.*

4. Kandidatët për kryetar dhe nënkryetar të KPK-së duhet të plotësojnë këto kritere:

a) të jenë persona që u përkasin pakicave kombëtare, sipas përcaktimit në pikën 2, të nenit 3, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”;

b) të jenë personalitete të shquara, me kontribute të spikatura në fushën e mbrojtjes së të drejtave të pakicave kombëtare;

c) të kenë eksperiencë pune jo më pak se 10 (dhjetë) vjet në fushën e mbrojtjes së të drejtave të pakicave kombëtare.

5. Shpallja e vendit të lirë për pozicionin kryetar dhe nënkryetar të KPK-së bëhet jo më vonë se 3 (tre) muaj nga data e përfundimit të mandatit të kryetarit dhe/ose nënkryetarit në detyrë, në Buletinin e Njoftimeve Publike, në faqen zyrtare elektronike të Kryeministrit dhe të KPK-së, për një periudhë 30-ditore.

6. Njoftimi për shpalljen përmban kriteret e përcaktuara në pikën 4, të këtij vendimi, dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit.

7. Komisioni *ad-hoc* bën vlerësimin e kandidaturave të paraqitura brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e mbylljes së afatit të dorëzimit të dokumentacionit, harton listën e kandidatëve të kualifikuar për kryetar dhe/ose nënkryetar të KPK-së, sipas renditjes së pikëve të grumbulluara, dhe ia propozon Kryeministrit.

8. Procesi i përzgjedhjes dhe i emërimit të anëtarëve të KPK-së zhvillohet pas emërimit të kryetarit dhe të nënkryetarit të këtij institucioni.

9. Të drejtën e propozimit të një kandidati për pozicionin e anëtarit të KPK-së e gëzon çdo shoqatë e regjistruar sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8788, datë 7.5.2001, “Për organizatat jofitimprurëse”, të ndryshuar, që në statutin e saj ka të përcaktuar si objekt të veprimtarisë

mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të pakicës kombëtare përkatëse, sipas përcaktimit në pikën 2, të nenit 3, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

10. Personat që u përkasin pakicave kombëtare, sipas përcaktimit në pikën 2, të nenit 3, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, mund të aplikojnë si kandidatë, individualisht dhe që mbështeten, me rekomandim, nga të paktën pesë individë, që janë personalitete me kontribute të pakicës kombëtare përkatëse.

11. Shpallja për vendet vakante për pozicionin e anëtarit të KPK-së publikohet në faqet zyrtare të Kryeministrit dhe të Komitetit për Pakicat Kombëtare për një periudhë 30-ditore.

12. Në shpallje përcaktohen kriteret e përgjithshme që secili aplikant duhet të plotësojë, sipas legjislacionit në fuqi për rekrutimin e personave në administratën publike. Për shkak të specifikës së pozicionit, aplikanti për pozicionin e anëtarit duhet të plotësojë këto kriteret të posaçme:

a) të njohë gjuhën e pakicës kombëtare përkatëse (vetëm për ato pakica kombëtare që kanë gjuhën e tyre);

b) të ketë eksperiencë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet në fushën e mbrojtjes së të drejtave të pakicave.

### *13. Shfuqizuar.*

14. Komisioni *ad-hoc* kualifikon aplikantët që plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të posaçme. Aplikantët e kualifikuar i nënshtrohen një testimi me shkrim lidhur me njohuritë për legjislacionin, praktikën dhe situatën faktike të çdo pakice kombëtare përkatëse. Gjithashtu, me secilin nga kandidatët e kualifikuar zhvillohet edhe një intervistë e strukturuar me gojë. Në shpalljen për kandidim për pozicionin e lirë të anëtarit të KPK-së përcaktohen edhe modalitetet për zhvillimin e proceseve të parashikuara në këtë pikë.

15. Komisioni *ad-hoc*, në fund të këtij procesi, liston kandidatët sipas pikëve të marra në total dhe, nëpërmjet kryetarit të tij, i propozon Kryeministrit dy kandidaturat që kanë marrë vlerësimin më të mirë, sipas renditjes për secilën pakicë kombëtare.

16. Kryeministri përzgjedh, nga emrat e dërguar, kandidatin më të përshtatshëm për pozicionin e anëtarit të pakicës kombëtare përkatëse dhe e emëron atë për një mandat katërvjeçar.

17. Kryetari, nënkryetari dhe anëtarët në detyrë vijnë të ushtrojnë funksionet deri në zgjedhjen e kryetarit, të nënkryetarit dhe të anëtarëve të KPK-së, sipas këtij vendimi.

18. Procedura për zgjedhjen e kryetarit dhe të nënkryetarit të shpallet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

19. Procedura për zgjedhjen e anëtarëve të shpallet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga emërimi i kryetarit dhe i nënkryetarit.

20. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Arsimit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Komiteti për Pakicat Kombëtare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**